



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË  
BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Nr. 4335/prot.  
2

Tiranë, më 07.06.2021

Lënda: Dërgimi i Urdhrit nr. 241, datë 07.06.2021 të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për miratimin e rregullores “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së Influcencës Aviare në shpendë”.

**AUTORITETIT KOMBËTAR TË VETERINARISË DHE  
MBROJTJES SË BIMËVE**

**Tiranë**

**INSTITUTIT TË SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË**

**Tiranë**

**AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT**

**Tiranë**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Urdhrin nr. 241, datë 07.06.2021 të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për miratimin e rregullores “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së Influcencës Aviare në shpendë”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**MINISTËR**

**Milva Ekonomi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTRI

Nr. 4395 prot.

Tiranë, më 07.06.2021

URDHËR

Nr. 241, datë 07.06.2021

“PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES  
PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE  
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 21 të Ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë”, bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



## RREGULLORE

### **“PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË”**

1. Vendosjen në karantinë nga shërbimi veterinar rajonal i Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të fermave të shpendëve ku dyshohet ose është konfirmuar sëmundja e Influcencës Aviare.
2. Verifikimi i të gjithë fermave në zonat e dyshuara dhe të konfirmuara të shfaqjes së sëmundjes së Influcencës Aviare, sipas RUDA datë 31.05.2021 ora 24:00.
3. Përcaktimin e zonës së mbrojtjes dhe zonës së mbikqyrur nga Qendra Kombëtare e Krizës, sipas Urdhërit nr. 234, datë 2.6.2021 “Për miratimin e Planit të Kontigjencës së sëmundjes së Influcencës Aviare”, në zonat e shfaqura të sëmundjes së Influcencës Aviare.
4. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve nga fermat e konfirmuara zyrtarisht nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nëpërmjet testit të biologjisë molekulare RT-PCR për praninë e virusit të Influcencës Aviare, në zonën e mbrojtur në drejtim të tregjeve, thertoreve, nga ferma në fermë dhe në çdo destinacion tjetër.
5. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve nga fermat e konfirmuara zyrtarisht nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nëpërmjet testit të biologjisë molekulare RT-PCR për praninë e virusit të Influcencës Aviare në zonën e mbikqyrur në drejtim të tregjeve, nga ferma në fermë dhe në çdo destinacion tjetër. Lejohet lëvizja vetëm për në thertore e shoqëruar me certifikatë veterinare dhe raport analizë nga ISUV.
6. Ndalimin e tregjeve, panairëve, garave sportive dhe evenimente të tjera publike në zonat ku dyshohet ose është konfirmuar sëmundja e Influcencës Aviare.
7. Monitorimin e sëmundjes së Influcencës Aviare nga Autoritetit Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, në fermat e shpendëve në gjithë territorin e vendit.
8. AKVMB raporton çdo ditë në Qendrën Kombëtare të Krizës, për monitorimin dhe kontrollin e kryera në fermat e shpendëve në lidhje me sëmundjen e Influcencës Aviare.
9. Çdo pronar ose kujdestar kafshësh që lëviz shpendët në kundërshtim me pikën 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje do të penalizohet sipas legjislacionit në fuqi, përveç rasteve kur lëvizja e shpendëve është autorizuar nga veterineri zyrtar për t'u eliminuar dhe që shoqërohet me certifikatën përkatëse.
10. AKVMB të bashkëpunojë me Policinë e Shtetit për zbatimin e këtij urdhëri.
11. AKVMB të bashkëpunojë me veterinerët privat të fermave që pronarët e tyre të marrin masat për biosigurinë në fermë.
12. AKVMB të bashkëpunojë me ISHP për monitorimin dhe kontrollin e shëndetit publik.

13. AKVMB të bashkëpunojë me shërbimet veterinarë në njësitë e qeverisjes vendore për monitorimin e tregjeve të kafshëve dhe thertoreve.
14. AKVMB të bashkëpunojë me Agjencinë Kombëtare të zonave të Mbrojtura, në lidhje me monitorimin e shpendëve migratorë që shërbejnë si vektorë për përhapjen e sëmundjes në zona ujore.
15. AKVMB të informojë fermerët, që mbarështojnë shpendë, me anë të mjeteve të komunikimit në lidhje me shenjat e sëmundjes së Influcës Aviare me qëllim që të identifikojnë dhe njoftojnë në cdo rast dyshimi prezencën e sëmundjes në shpendë.